



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1014/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

né

rastin nr. KI85/16

Parashtrues

Esat Haxhiu

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 321/2015, të 16 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Görxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Esat Haxhiu nga fshati Klinë e Epërme, komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 321/2015, të 16 nëntorit 2015, të cilin e ka pranuar me 10 shkurt 2016, si dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, C. nr. 0577/2011, dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2026/2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 qershor 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtaues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 19 korrik 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 16 shtator 2016, Kolegji shqyrtaues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 29 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, duke paditur Qeverinë e Republikës së Serbisë për dëmin material dhe jo material që i është shkaktuar gjatë luftës në Kosovë, duke kerkuar kompensimin e atij dëmi në shumën të cilën e kishte cekur në padi.
10. Më 28 prill 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, me Aktvendimin, C. nr. 0577/2011, ka hedhur poshtë padinë e parashtruesit duke u shpallur inkompetente për të vendosur lidhur me padinë.
11. Gjykata Themelore në arsyetimin e vendimit të vet kishte theksuar se “*Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do shpallet inkompetente, do t'i anuloj veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë*”.

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.
13. Më 5 maj 2015, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 2026/2014, refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore.
14. Më 2 nëntor 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 16 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin, Rev. nr. 321/2015, e hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit me arsyetimin, se “revizioni mund të paraqitet vetëm kundër vendimit të formës se prerë, me të cilin përfundon procesi gjyqësor civil”.
16. Gjykata Supreme, më tej, arsyetoi “Andaj, për faktin se me aktvendimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së dytë nuk ka përfunduar procedura civile në mënyrë meritore me vendim gjyqësor të formës se prerë, por për shkakte procedurale në mungesë të kompetencës të gjykatave vendore për të gjykuar në këtë çështje juridike, është hedhur poshtë padia e paditësit, Gjykata Supreme gjeti se revizioni i paditësit është i pa lejuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se gjykatat e rregullta kanë pasur kompetencë që të vendosin lidhur me meritat e rastit, kurse në kërkesën drejtuar Gjykatës ai nuk ka theksuar shkelje të asnjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, përvèç që ka potencuar se kërkesën e ka parashtruar në harmoni me nenin 113.7, 21, 53, 54 dhe nenin 102. par 7, të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shtuar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
21. Më tutje, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë”.

22. Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka pretenduar në mënyrë specifike shkelje kushtetuese por se ka kontestuar rezultatin final të vendimeve gjyqësore, duke pretenduar se gjykatat e rregullta kanë qenë kompetente për vendimmarrje dhe është dashur të vendosin lidhur me padinë e tij.
23. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bëre nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, përvèç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
24. Gjykata më tej rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
25. Në të vërtetë, Gjykata thekson se detyrë e Gjykatës është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ose kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrarë (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, paragrafi 16 Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34 Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992; *Barbera, Messeque* dhe *Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68 Aktgjykimi GJEDNJ-së, i 6 dhjetorit 1988).
26. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta që ta paraqes rastin e tij në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Ka përdorur mjetet e ankimit, ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, andaj procesi në tërësinë e tij nuk mund të cilësohet si arbitrar apo i pa drejtë.

27. Fakti, që të dyja shkallët e gjykatave të rregullta kanë konstatuar se nuk kanë kompetencë territoriale për të gjykuar lidhur me padinë, ndërsa Gjykata Supreme ka hedhur poshtë si të palejueshëm revizionin, tregon se padia është shqyrtaur me kujdes dhe se, gjykatat gjerësisht kanë arsyetuar se pse kanë marrë një vendim të tillë, dhe gjithashtu, kanë përcaktuar qartë bazën ligjore në të cilën janë mbështetur kur kanë marrë aktvendimet që kontestohen.
28. Në rrethanat e rastit, Gjykata nuk gjen se vendimet e gjykatave të rregullta janë arbitrale apo janë tregues i ndonjë shkelje të së cilës do të drejtë apo liri themelore të garantuar me Kushtetutë, aq më tepër, kur as vet parashtruesi në kërkesë nuk ka cekur se ndonjë e drejtë i është cenuar, përpos që ka renditur disa nga to pa dhënë asnjë arsyetim lidhur me të drejtat e njeriut dhe duke potencuar në disa raste “praktikat e mira”.
29. Si përfundim, Gjykata konludon se kërkesa në baza kushtetuese nuk është arsyetuar *prima facie* dhe se, parashtruesi nuk është subjekt i shkeljes të ndonjë të drejtë kushtetuese, andaj në përpunje me rregullin 36 (2) a) dhe c) kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (a) dhe (c) të Rregullores së punës, më 13 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi